



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data
24.03.2021

Lënda: Sjellje në vëmendje.

Nr. Protokoll
2565

DREJTUAR: Kryeministria

Adresa: Bulevardi 'Dëshmorët e Kombit', Tiranë

Të gjitha Ministrive

PËR DIJENI: OSCE/ODIHR

Office for Democratic Institutions and Human Rights

Adresa: Hotel Mak Albania, kati I 1, Sheshi "Italia", Tiranë

Duke marrë në konsideratë raportet e para të depozituara nga monitoruesit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përmbushje të përgjegjësisë të veta dhe me qëllimin për të përgatitur, zhvilluar dhe administruar zgjedhjet e datës 25 prill, në përputhje me standardet më të mira për zgjedhje të lira, të drejta dhe të ndershme, i bën apel të gjithë drejtuesve të institucioneve publike të tregojnë vetëpërbajtje e të përmbushin detyrimet e tyre sipas Kodit Zgjedhor lidhur me zbatimin e nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar "Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore"

Respektimi i dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe standarteve të kërkuara, ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në standartet e procesit zgjedhor, si kusht kryesor për procesin integruar të vendit. Kjo tërheqje vëmendje t'u përcillet gjithashtu edhe organeve tuaja të varësisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

